

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ A.E.B COMPANY” SHPK

Më datë 04.02.2022 midis personave:

1. **Z. Altin Bojaxhiu** shtetas Shqiptar, lindur më 23.07.1979 dhe banues në Berat Lagjja "Jani Vruho" Rruga Antipatrea, me numër pasurie 6/719+1-1, zona kadastrale 8503, godinë 2 katëshe, kati i parë, person madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me NR 030195658 dhe Nr personal H40723051G

Pronarë të pjesëve të kapitalit themeltar siç tregohet më poshtë dhe dhe atyre që mund të bëhen më pas pronarë të pjesëve të kapitalit themeltar është hartuar statuti i Shoqërisë tregëtare me termat e mëposhtëm:

KAPITULLI I

EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA


Neni I

Forma

1. Shoqëria tregëtare "A.E.B COMPANY" (më poshtë shënuar "shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie tregëtare me përgjegjësi të kufizuar.

Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

2. Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo çështje e paparishikuar shprehimisht në të, rregullohet sipas legjislacioni shqiptar në fuqi.



Neni 2

Emërtimi

1. Shoqëria emërtohet **“A.E.B COMPANY”SH.P.K.**Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.
2. Të gjitha shkresat,formularët e urdhërave apo çdo dokument tjetër korespondence,nxjerrë nga shoqëria,degët apo zyrat e përfaqësimit,nëpërmjet përdorimit të letrës apo mjeteve elektronike,të cilat u drejtohen palëve të treta,duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
 - a. Numrin unik të identifikimit;
 - b. Formën ligjore të shoqërisë, SH . P . K;
 - c. Vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
 - d. Të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
 - e. Vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit.

Neni 3

Selia

1. Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në Lagjen “Jani Vruho”Rruga Antipatrea Berat me numër pasurie 6/719+1-1,zona kadastrale 8503,godinë 2 katëshe,kati i pare.Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi,mund të hapë si në Shqipëri dhe jashtë saj,qendra,përfaqësi,filiale,degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 4

Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat,duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të përcaktohet një afat kohëzgjatje i cili mund të ndryshohet një ose më shumë herë,sërish me një vendim të Asamblesë së Ortakëve.



Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Import,eksport,tregtim i artikujve të të gjitha llojeve me shumicë dhe pakicë.
- Prodhim,tregtim konfeksionesh të të gjitha llojeve.
- Tregtim artikuj të ndryshëm industrial
- Tregtim artikuj të ndryshëm ushqimorë.
- Tregtim makineri të ndryshme.

Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e sa,brenda limiteve të parashikuara nga legjislatiioni në fuqi.

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj.

Neni 6

Përgjegjësia

1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit.

KAPITULLI II

KAPITALI I REGJISTRUAR,KONTRIBUTET,NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Neni 7

Kapitali

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë)lekë.
2. Kapitali themeltar është i përbërë nga 1(Një) kuotë kapitali i ndarë në:
 - Altin Bojaxhiu 1(një) kuotë me vlerë të përgjithshme
 - 100.000 (njëqind mijë) lekë.



Neni 8

Kontributet dhe kuotat e kapitalit themeltar

1. Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në masën dhe mënyrën e mëposhtme:
 - a. Z. Altin Bojaxhiu ka kontribuar në para në shumën 100.000 (Njëqind mijë) lekë.
2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:
 - a. Z. Altin Bojaxhiu është zotërues i 1 (një) kuotë kapitali me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) lekë ose 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 9

Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar.

1. Kapitali i regjistruar mund të rritet pa kufij në çfardo momenti, një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
2. Në rast rritjeje të kapitalit të regjistruar, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me kuotat e kapitalit të zotëruar.
3. Në rast se ata nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesëmarrjen respektive dhe në rast mungese të nënshkrimit mund të nënshkruhen nga të tretët me miratim të ortakëve.

Neni 10

Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

1. Me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar. Në të gjitha rastet kapitali i regjistruar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
2. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe miratimin e ortakut/ëve përkatës, shoqëria ka të drejtën e anulimit dhe likuidimit të kuotave të kapitalit. Me anulimin e tyre, të drejtat e detyrimit që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës shuhet.



Neni 11

Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit

1. Zotërimi i kuotave ,mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave,pjesëtimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin 9901 datë 14.04.2008”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe nga përcaktimet e këtij neni në vijim.
2. Kuotat e kapitalit mund t`u transferohen të tretëve ose ortakëve tërësisht ose pjesërisht,vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.
3. Ortaku që kërkon të transferojë kuotat e tij duhet të njoftojë për projektin e tij si administratorin ashtu edhe secilin ortak.Njoftimi duhet të bëhet me letër rekomande me kthim përgjigje për marrjen e njoftimit.Mbledhja e Asamblesë për miratimin ose refuzimin e projektit të transferimit duhet të bëhet brenda 3 muajve nga data e njoftimit.
4. Vendimi i ortakëve i njoftohet transferuesit me letër rekomande me kërkesë për marrje lajmërimi për marrjen e vendimit.Në rast se shoqëria nuk ka vendosur brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit,miratimi konsiderohet i dhënë.
5. Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi,ortakët duhet të blejnë ose të lejojnë blerjen e kuotave të kapitalit me vlerësimin e të drejtave me ekspert vlerësues të caktuar nga palët,ose kur ata nuk merren vesh ndërmjet tyre,me ekspert të caktuar nga Gjykata.
6. Kontrata e kalimit të kuotës hartohet në formë shkresore dhe sipas modaliteteve të përcaktuara nga Administratorët.Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.
7. Ortakët mund të vendosin që blerja e kuotave të kryhet nga vetë shoqëria duke zvogëluar kapitalin themeltar të shoqërisë.



8. Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes bëhet me miratim të ortakëve me kushte jo më pak të favorshme se ato të caktuara nga të tretët.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA,ADMINISTRIMI,KONTROLLI

Neni 12

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. Ndryshimet e statutit
 - c. Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të regjistruar;
 - e. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën”c” dhe “d” të kësaj pike;
 - f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët,përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat”g”dhe”h” të paragrafit të mësipërm,pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatës.
3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak,të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.Të gjitha vendimet e marra nga

Ortaku i Vetëm regjistronen në një regjistër të vendimeve,të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo fshihen.Duhet regjistruar ne veçanti,po pa u kufizuar vetëm në to,vendimet për:

- a. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c. Investime
- d. Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm dhe të paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 13

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- a. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901 datë 14.04.2008”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”i ndryshuar,nga ligje të tjera,nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.***Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.***
- b. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori/ët apo ortakët e pakicës siç është e përcaktuar në nenin 84 të ligjit 9901 datë 14.04.2008”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”i ndryshuar.
- c. Asambleja e Përgjithshme thirret nëse,sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare,rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- d. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrën tjetër aktive,të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë,që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- e. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria,brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj,propozon të blejë nga një ortak pasuri,që kanë vlerë më

P. O. 24

të larte se 5% të aseteve të shoqërisë,që rezulton në pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

- f. Në rastet e parashikuara në pikat “c” dhe “e” të këtij neni,Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një Ekspert Kontabël i Regjistruar,i pavarur.
- g. Dispozitat e pikës “f” të këtij neni nuk zbatohet nëse blerjet,sipas pikave “d” dhe “e” të këtij neni,kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.Gjithashtu këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një Ortak i Vetëm.
- h. Në rastet e parashikuara në pikat “c” deri në “e” të këtij neni,Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese,duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 14

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike.Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin,datën,orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t`u dërgohet të gjithëve ortakëve,jo më vonë se 7 Ditë të Plota përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- 2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit të parë të këtij neni,ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime,pavarësisht parregullsisë.
- 3 Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë,mund t`i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim,përfshirë postën elektronike,për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.



Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë t'a thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej tyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të ndjekë rrugët ligjore të përcaktuara në nenin 84 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Neni 15

Përfaqësimi në Asamble, kourumi, marrja e vendimeve

1. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
2. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme ndahen në vendime që kërkojnë një shumicë të zakonshme dhe në vendime të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar. Vendimet që kërkojnë shumicë të kualifikuar janë vendimet: *për ndryshimet e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.*
3. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të këtij statuti.
4. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kourumit të përmendur më sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



5. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështjet që kërkojnë shumicë të kualifikuar si: *për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.*
6. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Asambleja Përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera të zakonshme, me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
7. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, vendimet që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, kushtëzohen nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 16

E drejta e pjesëmarrjes dhe e votimit

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e vet dhe të marrë pjesë nëpërmjet votës së tij në vendime. Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo një person i tretë. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si ortaku që përfaqëson.
3. Një ortak nuk mund të delegojë të drejtën për të votuar, në emër të një pjese të kapitalit të tij themeltar, duke votuar personalisht për pjesën tjetër të kapitalit themeltar.
4. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund të sigurojnë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme

komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakeve dhe të plotësohen kërkesat e ligjit 9901 datë 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

5. Ortakët kanë të drejtën, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.
6. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Neni 17

Procesverbalet e Mbledhjes së Asamblesë

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si dhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.

Neni 18

Hetimet e posaçme

1. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimit të posaçëm për parregullsitë përgjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar për hetimet e posaçme.



Neni 19


Administratorët, emërimi, shkarkimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administratorë persona fizikë, qofshin këta dhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori/ët qëndrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiarë, me mundësinë për t'u rizgjedhur.
2. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. **Administratori i shoqërisë është Znj. Anisa Shkurti, shtetase shqiptare, lindur më 08.07.1987 në Berat dhe banuese në Berat, mbajtëse e letërnjoftimit me NR. 037017006 dhe me NR. personal 175708057Q. Mandati i administratorit është për një afat pesëvjeçar me të drejtë për t'u rizgjedhur.**

Neni 20

Kompetencat e Administratorit/ëve

1. Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumenta përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;



- d. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e. Raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë. Kryejnë detyra të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

3. Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

4. Administratori/ët kanë të gjitha të drejtat për të vepruar në marrdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti i`a jep Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



Neni 21

Përgjegjësitë e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Administratori detyrohet:
 - a. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimit të shoqërisë në mjedis;
 - b. Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d. Të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë;
 - e. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të

parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, kryen veprimet e mëposhtme:

- a. U kthen ortakëve kontributet;
- b. U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c. U shpërndan aktivet shoqërisë;
- d. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. Jep kredi.

7. Ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër Administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 22

Skualifikimi dhe largimi i Administratorëve

1. Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a. Personi pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar duke përfshirë parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të këtij ligji.
- b. Personi ndodhet në gjëndje paaftësie paguese;
- c. Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- d. Personi jep dorëheqje nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- e. Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura

gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 23

Ekspertët Kontabël

1. Shoqëria do të kontrollohet nga një ose më shumë Auditues Ligjor (Ekspertë Kontabël) të zgjedhur nga lista e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme, sipas kërkeave dhe rregullave të legjislacionit për auditimin e pavarur.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 24

Viti financiar dhe pasqyrat financiare

1. Viti financiar fillon më 01 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë dhe përfundon në 31 dhjetor të të njëjtit vit.
2. Pasqyrat financiare, raporti i administrimit dhe Ekspertit/ve Kontabël të Regjistruar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve sipas kushteve të parashikuara në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ndryshuar dhe statute.

Neni 25

Marrdhëniet ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve



1. Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, ortakët kanë të drejtë të përcaktojnë destinacionin e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare. Fitimi i deklaruar, mund të destinohet për rritjen e kapitalit të rregjistruar, shpërndarje në formë dividendesh, fitim të pacaktuar apo ndonjë rezervë tjetër që vendos Asambleja. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit, aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim, bazuar në një çertifikatë të aftësisë paguese të lëshuar nga administratori. Këto kërkesa, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një marrëveshje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut, e cila përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë në krahasim me kushtet normale të tregut.
3. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e çertifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni.

KAPITULLI V

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË NË GJËNDJEN E AFTËSISË PAGUESE

Neni 26

Prishja, Likuidimi

1. Përgjatë rastet e një prishje të parashikuar nga ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, shoqëria mund të prishet në çdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
2. Përveç rastit të bashkimit ose ndarjes, prishja e shoqërisë për çfarëdo shkakut qoftë sjell likuidimin e saj. Likuidimi kryhet nga një ose disa likuidues të emëruar nga Asambleja, të cilët kryejnë këtë detyrë në përputhje me statutin e shoqërisë, ligjin



Nr.9901 datë 14.04.2008”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”i ndryshuar dhe kërkesat e tjera ligjore.

3. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve,brenda 30 ditëve pas prishjes,çdo person i interesuar mund t`i drejtohet gjykatës,për të caktuar një likuidues.
4. Likuiduesi përfaqëson shoqërinë.Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë,mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe të kontributeve të pashlyera,shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar rradhën e referimit,sipas nenit 605 të Kodit Civil,shpërblimin e likuiduesit/ve së bashku me rimbursimin e shpenzimeve dhe aktivet e mbetura u shpërndahen ortakëve në përpjestim me kuotat në kapitalin e regjistruar.
5. Me përfundimin e procedurës së likuidimit të shoqërisë,Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar,mbi vlefshmërinë e punës së kryer nga likuiduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
6. Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedurë të përshpejtuar,nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët e saj dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrdhëniët me punëmarrësit.
7. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura,likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë,në përputhje me ligjin”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Riorganizimi i shoqërisë

1. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve shoqëria mund të organizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër,nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore,në përputhje me kërkesat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”i ndryshuar dhe dispozitave të tjera ligjore.



Neni 28

Kundërshtimet

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, midis ortakëve ose një apo më shumë prej tyre dhe shoqërisë, do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarve për t'i zgjithur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksonit të Gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 29

Baza ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit NR.9901 datë 14.04.2007 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Kodi Civil, legjislacioni tregtar dhe çfardo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 30

1. Statuti i shoqërisë pasi u lexua nga Ortakët e Shoqërisë u nënshkrua prej tyre pa vërejtje.

Ky statut është përgatitur në katër kopje të barazvlerëshme në gjuhën shqipe.

ORTAKËT E SHOQËRISË "A.E.B COMPANY" SH.P.K

ALTIN BOJAXHIU

